

URDHËR
Nr. 374, datë 30.8.2021

**PËR HYRJEN E PERSONAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA TË
GJITHA PIKAT KUFITARE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 3, shkronja “a”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si edhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga coronavirusi i ri nr. 3614 prot., datë 30.8.2021,

URDHËROJ:

1. Të gjithë personat që hyjnë në Republikën e Shqipërisë, nga të gjitha pikat kufitare, duke filluar nga data 6.9.2021, duhet të paraqesin një nga dokumentet e mëposhtme:

a) certifikatën e vaksinimit që vërteton vaksinimin e plotë, në formë digjitale apo të printuar, apo një dokument të ngjashëm të lëshuar nga autoritetet kompetente shëndetësore vendase që deklarën përfundimin e vaksinimit;

b) test PCR-je, të kryer brenda 72 orëve përpara nisjes ose testin e shpejtë antigjenik brenda 48 orëve të hyrjes në kufi;

c) dokument të lëshuar nga autoritetet shëndetësore të vendit, që provon shërimin nga infeksioni Sars-Cov-2, me vlefshmëri deri në 6 muaj pas shërimit.

2. Dokumentet e kërkuara në pikën 1, të këtij urdhri, duhet të paraqiten edhe nga personat që kalojnë tranzit në Republikën e Shqipërisë.

3. Përrjashtim nga rregullat e përcaktuara në pikën 1 dhe 2, të këtij urdhri, bëhet për fëmijët deri në moshën 6 vjeç.

4. Personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dhe ata persona me leje qëndrimi të përkohshme apo të përhershme dhe që nuk kanë asnjë nga dokumentet e përmendura në pikën 1, të këtij urdhri, duhet të nënshkruajnë deklaratë në pikën kufitare dhe të vetëizolohen për një periudhë 10-ditore, duke informuar autoritetet shëndetësore për të kryer testimin në fund të periudhës së izolimit.

5. Urdhri t'i përcillet ministrisë përgjegjëse për çështjet e jashtme, me qëllim njohjen e tij nga të gjithë përfaqësitë diplomatike në Republikën e Shqipërisë.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente të përcaktuara në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu